

## **Avokimi publik i Nismës për KOMRA**

Raport, 7.07.2011.

Përkrahja e parë politike Nismës për KOMRA ka ardhur nga Parlamenti i Malit të Zi. Gjatë konsultimeve me deputetët e parlamentit të mbajtur më 30.06.2010, kryetari i parlamentit Ranko Krivokapiq dhe deputetët kanë dhënë përkrahjen e plotë nismës qytetare për themelimin e Komisionit Rajonal për faktet në lidhje me viktimat dhe krimet e luftës. Pasi edhe mbështetja nga kryetari i Republikës së Kroacisë, z. Ivo Josipović (31. gusht 2010) dhe kryetari i Republikës së Serbisë, z. Boris Tadić (1 shtator 2010).

Pastaj, Nën Komisioni për të drejtat e njeriut i Parlamentit Evropian, në takimin e datës 30.09. 2010, në Strasburg, ka dhënë mbështetjen e plotë nismës civile për themelimin e KOMRA-s. Drejtori i delegacionit për marrëdhënie me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën, z. Eduard Kukan, ka ftuar Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian që në afat të gjatë të mbështesin “nismën e përbashkët”. Në të njëjtin rast, drejtori për Ballkanin perëndimor në Drejtorinë përgjithshme për zgjerim në Komisionin evropian z. Pierre Mirel ka thënë: “KOMRA është një plotësim i domosdoshëm në proceset gjyqësore, dhe për të duhet të marrim mbështetjen e plotë të qeverive dhe parlamenteve”. Kryetarja e Nën Komitetit për të drejtat e njeriut të Parlamentit Evropian, znj. Heidi Hautulla, ka vlerësuar se “kjo është hera e parë që një iniciativë e këtillë, kaq e rëndësishme, të vijë nga poshtë drejtë nesh”.

Në takimin e Katërt interparlamentar të Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë dhe Parlamentit Evropian, me 5.10. 2010 në Beograd, kryetari i Komisionit për integritet evropian i Kuvendit popullor të Serbisë, z. Laslo Varga, kryesues i delegacionit të Parlamentit Evropian për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën, dhe z. Eduard Kukan, kanë shprehur mbështetjen e tyre ndaj iniciativës regjionale për themelimin e KOMRA.

Parlamenti Evropian, në Rezolutën e miratuar me 19.01. 2011, ka mbështetur Nismën e KOMRA, si proces për ngritjen e vetëdijes dhe pajtimit gjithandej Ballkanit perëndimor dhe ka ftuar pushtetin e Serbisë, dhe vendeve të tjera, të ofrojnë mbështetje për këtë iniciativë.

Asambleja Parlamentare, me 26.01. 2011, ka miratuar raportin e raportuesit Komitetit për punë të jashtme të Këshillit të Evropës, z. Pietro Marcenaro, i cili ka ftuar “të gjitha vendet në rajonin e ish Jugosllavisë të marrin pjesë në themelimin e KOMRA, pavarësisht nga statusi i tyre, në mënyrë që ai Komision të realizojë funksionin e pajtimit të plotë dhe pranimit të viktimave”. Asambleja parlamentare ka miratuar Rezolutën 1786 (2011), me të cilën, posaçërisht, është theksuar mbështetja ndaj nismës për formimin e Komisionit rajonal për vendosjen e fakteve mbi krimet e luftës në territorin e ish RSFJ-së (KOMRA), i cili ka për qëllim që të shpreh respekt dhe t’i pranoj të gjitha viktimat.

### **1.1. Avokimi publik në Bosnje dhe Hercegovinë**

Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (SDA) Sulejman Tihqi është takuar me përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA më 15.02.2011 në Sarajevë. Në përkrahjen e tij Nismës për KOMRA, kryetari Tihqi

theksoi se qasja rajonale ka potencial që të kontribuojë në ndriçimin e ngjarjeve gjatë luftërave dhe parandalojë përsëritjen e krimeve në të ardhmen.

Koalicioni për KOMRA u takua më 28.03.2011 me kryetarin e Partisë Popullore “Radom za boljitaK” Mlladen Ivankovićin i cili i dha përkrahje themelimit të KOMRA-s duke theksuar rëndësinë e qasjes rajonale në vërtetimin e fakteve të cilat duhen t’i lihen gjeneratave të ardhshme.

Disa ministra në nivel të Federatës së BeH nga radhët e Partisë Social Demokratike (SDP) kanë përkrahur themelimin e KOMRA-s. Kryetari i Partisë Zdravko Llagumxhija gjatë takimit me përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA më 15.02.2011 ka theksuar përkrahjen në parim Nismës për themelimin e KOMRA-s.

Në takim me anëtarët e Koalicionit për KOMRA më 10.05.2011, kryetari dhe nënkryetari i Federatës së BeH, z. Zhivko Budimir dhe z. Svetozar Pudariq kanë përshëndetur detyrat e KOMRA-s që të ndihmojnë në ndriçimin e fatit të personave të zhdukur. Kanë paralajmëruar në rrezikun nga elitat politike në rajon të cilat kanë interes të mbajnë gjendjen e tanishme. Nënkryetari i dytë i Federatës së BeH Mirsad Kebo ka përkrahur Nismën për KOMRA më herët, duke nënshkruar petitionin për themelimin e KOMRA-s.

Udhëheqësia e Bashkësia Demokratike Kroate (HDZ) BeH me të cilët anëtarët e Koalicionit për KOMRA janë takuar më 23.05.2011 planifikon konsultimet me anëtarët e partisë dhe shoqatat kroate të viktimave mbi përkrahjen eventuale Nismës për KOMRA. Në emër të HDZ 1990 nënkryetari, Martin Raguzh ka përkrahur Nismën për KOMRA dhe ka shprehur gatishmërinë që të llobojë në Parlamentin e BeH për marrjen e vendimit mbi themelimin e Komisionit Rajonal.

Përkrahjen themelimit të KOMRA-s ka dhënë edhe “Naša stranka” si dhe një numër i madh i kryetarëve të komunave në Federatën e BeH.

Nga Republika Srpska ka reaguar kryetari i Komunës së Prijedorit njëherësh edhe kryetar i Partisë Demokratike, Marko Paviq. Në ftesën për takim të Koalicionit për KOMRA në përgjigjen e dërguar më 30.05.2011 ka prezantuar qëndrimin se faktet mbi krimet e luftës me të cilat duhet të merret KOMRA mund t’i vërtetojë vetëm historia.

Koalicioni për KOMRA ka dorëzuar Nismën dhe Peticionin me 500.000 nënshkrime e përkrahjes për themelimin e KOMRA si dhe Propozim Statutin e KOMRA anëtarit të Kryesisë së BeH Zhelko Komshiqit më 23. 06. 2011.

## **1.2. Avokimi publik në Mal të Zi**

Kryeministri i Malit të Zi Igor Llukshiq ka përkrahur themelimin e KOMRA-s në takimin me përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA më 29. 04. 2011. godine.

Presidenti i Malit të Zi Fillip Vujanović përmes një letre të dërguar Koalicionit për KOMRA më 11.05.2011 edhe formalisht ka përkrahur krijimin e Komisionit Rajonal.

Themelimin e KOMRA-s e kanë mbështetur edhe klubet parlamentare të Partisë social –demokrate (*Socijaldemokratske partije*), Partisë Boshnjake (Bošnjacke stranke), Partisë popullore socialiste

(*Socijalističke narodne partije*), Demokracisë së re serbe (*Nove srpske demokratije*), Partisë demokratike socialiste (Demokratske partije socijalista), si dhe partitë shqiptare.

Qeveria e Malit të Zi në qershor të vitit 2011 ka njoftuar Koalicionin për KOMRA se ka formuar grupën punuese për shqyrtimin e Nismës për KOMRA.

### **1.3. Avokimi publik në Kroaci**

Kryetari i Republikës së Kroacisë, z. Ivo Josipović, me 16.05. 2011, për herë të dytë ka shprehur mbështetjen për Nismën për KOMRA. Në takim me antarët /anëtarët e Koalicionit për KOMRA, kryetari z. Josipović ka theksuar që çdo përkushtim që të vërtetohet fati i të humburve, të shënohet çdo viktimë dhe të dënohet çdo krim, është i rëndësishëm për viktimat, familjet dhe shoqërinë në tërësi.

Mbështetje për Nismën për KOMRA kanë shprehur edhe nënkryetari i Qeverisë së Republikës së Kroacisë, z. Slobodan Uzelac, Partia Demokratike e Pavarur Serbe (*Samostalna demokratska srpska stranka*), si dhe ish kryetari i Republikës së Kroacisë z. Stjepan Mesić.

Nismën për KOMRA e kanë mbështetur edhe përfaqësuesit në Parlamentin Kroat, z. Damir Kajin (Istarski demokratski Sabor), dhe z. Ratko Gajica (përfaqësues i pavarur), si dhe përfaqësuesit e Partisë Social-demokratike të Kroacisë znj. Ingrid Antičević- Marinović, z. Šime Lučin, znj. Mirela Holy, z. Josip Leko dhe z. Davorko Vidović. Përkrahjen themelimit të KOMRA-s e ka ofruar edhe Kryebashkiaku i Vukovarit dhe anëtari i SDP-së Zhelko Sabo.

Partia Social Demokratike e Kroacisë nuk e ka përkrahur themelimin e KOMRA. Kryetari i saj Zoran Milovanović konsideron se regjistrimi i viktimave dhe vërtetimi i fakteve mbi krimet e luftës detyrë e secilit shtet dhe se nuk guzon të bartet në nivel rajonal apo trpë rajonale.

Peticionin për themelimin e KOMRA dhe Propozim Statutin e KOMRA-s i janë dorëzuar kryetarit të Kroacisë Ivo Josipović më 21.06.2011. Me atë rast ai ka thënë se do të promovojë Nismën për KOMRA në kuadër të aktiviteteve të tij rajonale dhe në komunikim me Qeverinë e Republikës së Kroacisë dhe partitë politike parlamentare.

### **1.4. Avokimi publik në Kosovë**

Anëtarët e Koalicionit për KOMRA kanë prezantuar Nismën për KOMRA kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës Isa Mustafës më 16.03.2011 i cili ka theksuar përkrahjen dhe gatishmërinë e partisë së tij që në Parlamentin e Kosovës të votojë vendimin për themelimin e KOMRA-s. Koalicioni për KOMRA më 18.03.2011 ka pasur takim me nënkryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Ardian Gjini i cili i ka dhënë përkrahjen e plotë themelimit të KOMRA-s.

Nismën për KOMRA e ka mbështetur edhe znj. Rada Trajković, bartëse e Listës unike serbe (*Jedinstvene srpske liste*). Ajo, me datën 16.05.2011, në deklaratat e saja për media ka pohuar se KOMRA nuk guxon të humbë rastin, sepse Komisioni është rast unik që të zbulohet fati i të humburve dhe të vërtetohen faktet mbi krimet e luftës.

Ministri i shëndetësisë së Kosovës z. Ferid Agani, në takim me anëtarët e Koalicionit për KOMRA, me dt. 07 qershor 2011, ka porositur se KOMRA është rruga e vetme drejt të vërtetës mbi krimet, të cilat i fshehin interesat politike.

Koalicioni për KOMRA nuk ka arritur që Presidentes së Kosovës Atifete Jahjaga t'ia dorëzojë Nismën për themelimin e KOMRA-s, Peticionin me 500.000 nënshkrime dhe Propozim Statutin e KOMRA-s. Kabineti i saj për herë të dytë ka njoftuar Koalicionin për KOMRA se ajo nuk është kompetente të pranojë Nismën për themelimin e KOMRA-s.

#### **1.5. Avokimi publik në Maqedoni**

Nismën për KOMRA në Maqedoni e kanë mbështetur deputetët e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, (*Sobranie na Republika Makedonija*), znj. Zymrete Jakupi (*Unioni Demokratik për Integrim*), dhe Stojan Andov (*Liberalna partija*), nënkryetari i Partisë liberale g. Ivan Veličkovski, anëtari i Komisionit ekzekutiv të Lidhjes social- demokrate të Maqedonisë, dhe g. Dane Taleski, dhe *Partia Dostoinstvo*.

Koalicioni për KOMRA nuk ka arritur të caktojë takim me kryetarin e Maqedonisë George Ivanov për shkak të angazhimeve të tij në formimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

#### **1.6. Avokimi publik në Slloveni**

Në Slloveni Nismën për KOMRA e kanë mbështetur kryetari i Republikës së Sllovenisë z. Danilo Turk, kryetari i Parlamentit të Sllovenisë, z. Pavel Gantar, si dhe deputetët e Kuvendit shtetëror (*Državni zborna*), z. Anton Aderlič (*Liberalna demokracija Slovenije*), dhe znj. Eva Irgl (*Slovenska Demokratska stranka*), Avokatja e popullit znj. Zdenka Čebašek Travnik, dhe deputetët në Parlamentin Evropian Jelko Kacin dhe Tanja Fajon.

Kryetari Turk ka përshëndetur faktin që nisma për themelimin e KOMRA-s ka rrjedhë nga shoqëria civile, duke theksuar që, si e tillë, mund të kontribuojë në vërtetimin e fakteve dhe në procesin e pajtimit.

Anëtarët e Koalicionit për KOMRA kanë mbajtur takime informative me këshilltarin e presidentit të Sllovenisë Lladisllav Llipiqin më 01.06.2011 dhe udhëheqësen e Sektorit për të drejtat e njeriut në Ministrinë e Punëve të Jashtme Evom Tomiq më 07.06.2011 në lidhje me marrëveshjen për dorëzimin e Nismës për KOMRA.

Koalicioni për KOMRA ka dorëzuar e ka dorëzuar më 22.06.2011 Nismën dhe Peticionin për themelimin e KOMRA-s si dhe Propozim Statutin e KOMRA-s sekretarit shtetëror Jozhef Shkollqit në kabinetin e presidentit të Sllovenisë.

#### **1.7. Avokimi publik në Serbi**

Nismën për KOMRA, publikisht e kanë mbështetur kryetarja e Kuvendit Popullor të Republikës së Srbisë znj. Slavica Đukic -Dejanović, kryeministri KA te Vojvodinës, z. Bojan Pajtić dhe kryetari i Kuvendit të Vojvodinës, z. Šandor Egerš. Iniciativën e kanë mbështetur edhe klubet e deputetëve të Partisë Demokratike, Partisë Socialiste të Serbisë, Partisë së Pensionistëve të Bashkuar të Serbisë dhe Grupi i

pakicave . Pastaj, Partia Demokratike, Rajonet e bashkuara të Serbisë, Lëvizja e veteranëve, Lëvizja e përtëritjes serbe, Lidhja social -demokratike e Vojvodinës, dhe Partia liberal – demokratike.

Në përkrahjen e saj Nismës për KOMRA, kryetarja e Parlamentit Sllavica Gjukiq Dejanoviç në veçanti është ndalur tek regjistri i të vrarëve gjatë luftërave në hapësirën e ish-RSFJ-së.

Kryetari dhe deputetët e Kuvendit të Vojvodinës kanë përkrahur Nismën për KOMRA më 01.06.2011 me nënshkrimin publik të Peticionit për themelimin e KOMRA-s dhe me deklaratat përkrahëse për themelimin e KOMRA-s.

Kryetari i Qeverisë së Vojvodinës Bojan Pajtiq në deklaratën e tij dhënë mediave ka thënë se beson që KOMRA mund të kontribuojë në vendosjen e paqes dhe stabilitetit në rajon. Ka theksuar se “çdo viktimë meriton emrin dhe mbiemrin, çdo kriminel dënimin dhe të gjithë qytetarët të vërtetën dhe drejtësinë”.

Partia Demokratike në konferencën për shtyp me përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA më 17.05.2011 ka deklaruar se e jep përkrahjen politike dhe operative në përkrahje për themelimin e KOMRA-s. Në interes të Serbisë është që të vërtetohen faktet mbi atë se çfarë ka ndodhur gjatë luftërave ngaqë kjo është e vetmja rrugë drejt pajtimit në rajon tha nënkryetarja e kësaj partie Jellena Trivan.

Përfaqësuesit e Koalicionit për KOMRA kanë biseduar më 16.06.2011 me presidentin e Serbisë Boris Tadiq mbi fazat e më tutjeshme të procesit KOMRA. Ai ka ripërsëritur përkrahjen për themelimin e KOMRA-s.

Koalicioni për KOMRA ende nuk ka arritur që t’ia dorëzojë Nismën Presidentit të Serbisë, Peticionin me 500.000 nënshkrime për themelimin e KOMRA-s dhe Propozim Statutin për shkak të agjendës së tijtë ngarkuar.